



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Departamenti i Industrisë - Divizioni për Politika Industriale

Paga e Dinjitetshme në Sektorin Prodhues/Përpunues

HYRJE

Paga e dinjitetshme, është pagesë e marrë për një muaj, që është e mjaftueshme për të përballur një standard të mirë jetese për një punëtor dhe familjen e tij. Ajo duhet të jetë e mjaftueshme për të siguruar të gjitha nevojat bazë, si dhe disa të ardhura për të mbuluar ngjarjet e papritura.

Në shumicën e vendeve, një pagë e dinjitetshme (jetese) është më e lartë se paga minimale e përcaktuar nga qeveria dhe si rezultat, shumë pronar të bizneseve bazohen në pagën minimale të përcaktuar nga qeveria. Me gjithat logjika e përcaktimit të pagës në këtë formë është e gabuar dhe se bizneset mund të kenë probleme për punëtorë në të ardhmen.

Autor të ndryshëm mendojnë se paga e dinjitetshme, duhet të shikohet nga bizneset si investim për sukses dhe jo si një kosto për të zbutur pakënaqësitë të punëtorët.

Në nivel të përgjithshëm paga e dinjitetshme (jetesës) mund të forcojnë stabilitetin, performancën dhe qëndrueshmërinë e zinxhirit të vlerës. Nuk duhet të jetë çudi që shumë biznese theksojnë një korrelacion të drejtpërdrejtë midis performancës së furnitorëve dhe trajtimit të punëtorëve.

Nisur nga parimi se për të trajtuar këtë çështje nuk i takon vetëm komunitetit të biznesit, ekziston arsyeje e mirë që qeveritë të ndërmarrin iniciativa dhe stimuj për të nxitur bizneset të reflektojnë në ofrimin e pagave të dinjitetshme për punëtorët.

Të dhënat në këtë dokument prezantojnë ndërmarrjet e selektuara me pagë më të lartë mesatare të sektorit prodhues/përpunuese dhe jo të gjitha ndërmarrjet prodhuese/përpunuese

METODOLOGJIA

Metodologjia për realizimin e këtij aktiviteti mbështetet mbi të dhënat sasiore të Administratës Tatimore të Kosovës dhe të dhënave cilësore të pranuar nga vizitat e ndërmarrjeve me pagë mesatare më të lartë të ofruara për punëtor.

Nga ATK janë pranuar 100 ndërmarrje me pagë më të lartë mesatare për muajit (janar-qershor, 2023), të dhënat janë plotësuar edhe me numrin e të punësuarve. Për llogaritjen e pikëve janë marrë për bazë dy kritere, kriteri me 70% për pagën më të lartë mesatare, 30% për numrin më të madh të punësuarve.

Ndërmarrjet janë grupuar sipas madhësisë: mikro ndërmarrjet deri 9 të punësuar, ndërmarrjet e vogla 10 – 49 të punësuar, ndërmarrjet e mesme 50-249 të punësuar dhe ndërmarrjet e mëdha mbi 250 të punësuar.

Pas grupimit të ndërmarrjeve sipas madhësisë, ndërmarrjet janë renditur sipas numrit më të madh të pikëve.


Ndërmarrjet me pikë më të larta sipas madhësisë së ndërmarrjeve, konkretisht 30% e ndërmarrjeve nga 100 ndërmarrjet me pagë më të lartë, janë kontaktuar dhe vizituar nga stafi i DI/DPI për të verifikuar nëse ndërmarrje merret me prodhim, për të shikuar ambientin ku punojnë të punësuarit dhe kushtet tjera.

Pas mbledhje së të dhënave nga tereni, janë plotësuar të dhënat e ndërmarrjeve të vizituara dhe është proceduar më tutje për rezultatet e analizës.

Veprimtaria Ekonomike

Ligji për Shoqëritë Tregtare, ofron përkufizimin e veprimtarisë ekonomike si, “Veprimtaria Ekonomike - do të thotë çdo lloj aktiviteti i rregullt ose i përsëritur i cili përfshin ofrimin, sigurimin ose prodhimin e mallrave, shërbimeve, pronës dhe/ose punëve për një person ose Shoqëri Tregtare, në këmbim ose në pritje të çfarëdo lloj pagese ose kompensimi; me kusht që punëtori i cili kryen shërbime për punëdhënësin e tij të mos konsiderohet se ushtron veprimtari ekonomike përderisa shërbimet e tilla të kompensohen sipas kontratës së punëtorit me punëdhënësin”.

Figura 1. Veprimtaria sipas regjistrimit dhe gjendjes reale gjatë vizitës



Burimi: vizita e ndërmarrjeve nga DI/DPI

Sipas figurës 1, 18% e ndërmarrjeve mikro të cilat ofrojnë pagë mesatare më të lartë në industrinë prodhuese/përpunuese praktikisht kanë ndryshuar veprimtarinë nuk janë në prodhim për derisa në regjistrat e ARBK-së dhe ATK-së figurojnë me veprimtari kryesore prodhuese/përpunuese.

Kalim nga veprimtaria prodhuese/përpunues në veprimtari tjetër, kanë deklaruar 11% të ndërmarrjeve të vogla, të cilat po ashtu në regjistrat e ARBK-së dhe ATK-së figurojnë si ndërmarrje me veprimtari kryesore prodhuese/përpunuese.

Te ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha të cilat ofrojnë pagë më të lartë mesatare nuk është vërejtur mos përputhje në ndryshim të veprimtarisë kryesore.

Kontratat e punës


Kontrata e punës është një marrëveshje ligjërish të detyrueshme midis një punëdhënësi dhe një punonjësi që përdoret për të përcaktuar marrëdhënien e punës.

Një ndër kriteret kryesore, të pagës së dinjitetshme është kontrata dhe respektimi i kontratës për punëtor.

Figura 2, pasqyron sigurimin e punëtorëve me kontrata pune, duke marrë parasysh se janë selektuar dhe vizituar ndërmarrjet me pagë më të lartë mesatare, atëherë rezultatet tregojnë se te niveli i këtyre ndërmarrjeve, në të katër kategoritë janë deklaruar se punëtorët kanë kontrata pune dhe respektohet orari i punës sipas kushteve të kontratave dhe Ligjit të punës.

Punëtorët te kjo kategori e përzgjedhur e ndërmarrjeve, kanë deklaruar se respektohen kontratat e punës si në orar të punës, kompensim i orëve shtesë, pushime vjetore, shëndetësore etj.

Figura 2. Punëtorët me kontrata të punës



Burimi: vizita e ndërmarrjeve nga DI/DPI

Te ndërmarrjet mikro dhe të vogla të industrisë prodhuese/përpunuese, vërehet se menaxhimi apo mbikëqyrja e zbatimit të kontratave, nuk përcillen në mënyrë të rregullt përmes ndonjë personi përgjegjës edhe pse deklarohen se respektohen, deri sa te shumica e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha të selektuar me pagë më të lartë mesatare, rolet e stafit janë të përcaktuara dhe kanë një strukturë organizative të mirë, ku stafi i administratës merret me kontratat dhe zbatimin e tyre.

Sigurimet shëndetësore për punëtorët

Në Kosovë ekziston Ligj për Sigurimin Shëndetësor, me gjithat banorëve të Kosovës ende nuk u ofrohet sigurim shëndetësor publik, me përjashtim të disa ndërmarrjeve të cilat janë duke e aplikuar sigurimin shëndetësor për të punësuarit.

Nga ndërmarrjet e industrisë përpunuese/prodhuese të selektuara me pagë më të lartë mesatare dhe të kontaktuara, në bazë të deklarimeve të përfaqësuesve të ndërmarrjeve, rezulton se sigurimet shëndetësore kanë gjetur zbatim me rreth 11% te ndërmarrjet e vogla, 40% te ndërmarrjet e mesme dhe 66% te ndërmarrjet e mëdha të industrisë prodhuese/përpunuese të selektuara me ofrim të pagës më të lartë mesatare për të punësuarit.

Kushtet e punës


Të kuptuarit e menaxhimit të ndërmarrjeve është thelbësore për qasjen ndaj punëtorëve, në këtë rast ndërmarrjet e mëdha dhe të mesme kanë kuptuar se brenda ndërmarrjes duhet krijohet një ambient i punës ku i ofron punëtorëve më shumë mundësi për zhvillim, më shumë fuqi për të arritur sukses, efektivitet në punë.

E rëndësishme është se te ndërmarrjet prodhuese/përpunuese në kategoritë e mesme dhe të mëdha me pagë më të lartë mesatare, është kuptuar se kushtet e ekonomisë së sotme kërkojnë ambient të mirë për punë duke filluar nga aspekti fizik i vendit të punës, ofrimi i trajnimeve, avancim në karrierë, paga shtesë etj.

Është më se e domosdoshme që kapitali njerëzor të përmirësohet me qëllim të rritjes së produktivitetit, rritje së pagave dhe përmirësimit të kushteve të punës në përgjithësi.

Ndërmarrjet e mëdha ofrojnë kushte/ambient të punës më të mirë se konkurrentët e tyre të vegjël e sidomos mikro. Kushtet financiare ndikojnë që pronarët e ndërmarrjeve mikro në sektorin prodhues e kanë më të vështirë të ofrojnë kushte të punës kundrejt konkurrenteve të tyre të mëdhenjtë, kjo vështirëson gjetjen dhe mbajtjen e punëtorëve të kualifikuar.

Figura 3. Kushtet e punës/ambientit në ndërmarrjet e sektorit prodhues/përpunues



Burimi: vizita e ndërmarrjeve nga DI/DPI

Konkluzionet

- Disponueshmëria e të dhënave statistikore të besueshme dhe të krahasueshme, nuk është në nivelin e duhur ku një numër i ndërmarrjeve mikro dhe të vogla, në regjistrat e ARBK-së dhe ATK-së, aktivitet kryesor kanë paraqitur prodhimin deri sa aktivitet kryesor kanë tregtinë ose shërbimet.
- Sigurimet shëndetësore kanë gjetur zbatim te një numër i konsiderueshëm i bizneseve me pagë më të lartë, konkretisht te ndërmarrjet e mëdha dhe të mesme prodhuese /përpunuese.
- Respektimi dhe njohja efektive e së drejtës për punë të denjë dhe të qëndrueshme, duke përfshirë kushtet e sigurta të punës, është element themelor, në këtë rast ndërmarrjet e mëdha me pagë më të lartë mesatare dhe një numër i ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla, ofrojnë kushte të mira pune, me gjithat mungon promovimi se në disa ndërmarrje të sektorit prodhues ofrohen kushte të mira pune.

Rekomandimet

- Të punohet në disponueshmërinë e të dhënave statistikore të besueshme dhe të krahasueshme, ndërmarrjet e sektorit prodhues/përpunues me rastin e kalimit në veprimtari tjetër ekonomike duhet të bëjnë plotësim ndryshimin në ARBK.
- Të zhvillohen aktivitete apo në kuadër të aktiviteteve promovuese të mundësohet promovimi i punës së denjë dhe të qëndrueshme në të gjitha veprimtaritë e ndërmarrjeve prodhuese.
- Në bashkëpunim me partnerët socialë duhet të punohet për vende të sigurta të punës dhe të shëndetshme, në përputhje me instrumentet përkatëse të ILO-s.